



Misionit të OSBE-së në

Kosovë i është besuar roli

udhëheqës për çështjet që

kanë të bëjnë me ndërtim

institucional dhe të

demokracisë, me shtet ligjor

dhe me të drejta të njeriut

në rajon. Misioni e formon

kështu një komponentë të

veçantë apo "degë" të

Administratës së Përkohshme

të Misionit të Kombeve të

Bashkuara në Kosovë

(UNMIK), dhe ndër të tjera

është përgjegjës edhe për

trajnimin e administratorëve

të policisë, civil dhe ata të

drejtësisë; vazhdimin e

zhvillimit të shoqërisë civile;

përkrahjen e zhvillimit të

mediave; organizimin dhe

mbikqyrjen e zgjedhjeve; dhe

mbikqyrjen, mbrojtjen dhe

përparimin e të drejtave

të njeriut.

ORGANIZATA PËR SIGURI DHE BASHKËPUNIM NË EVROPË

Misioni në Kosovë

Organet Menaxhuese të Zgjedhjeve

Komisioni Qendror Zgjedhor

Komisionit Qendror Zgjedhor (KQZ) i formuar sipas rregullores 2000/21 të UNMIK-ut i është dhënë kompetenca shtesë në rregulloren e UNMIK-ut 2000/65 dhe ky organ "është përgjegjës për drejtimin e zgjedhjeve në Kosovë". Përgjegjësia e këtij komisioni është miratimi i rregullave zgjedhore përfshirë edhe rregullat për qeverisjen e partive politike, koalicioneve, iniciativave qytetare dhe kandidatëve të pavarur, përcjelljen e procesit zgjedhor nga mediat dhe ecurinë e votimit dhe numërimit.

Zëvendësi i PSSP-së për ndërtimin e Institucioneve, udhëheqësi i Misionit të OSBE-së, Ambasadori Paschal Fieschi, është kryesues i KQZ-së. Janë tre anëtarë ndërkombëtarë dhe nëntë anëtarë vendorë. Tre nga këta anëtarë janë emëruar nga partitë politike të përfaqësuara në Kuvendin e Kosovës, që paraprakisht kanë qenë anëtarë të ish-Këshillit të Përkohshëm Administrativ – KPA. Komunitetet e vogla të Kosovës kanë emëruar tre anëtarë të tjerë. Tre nga përfaqësuesit vendorë nuk kanë anim politik dhe përfaqësojnë komunitetin akademik, organizatat joqeveritare dhe mediat. Anëtarët janë emëruar nga Përfaqësuesi Special i Sekretarit të Përgjithshëm në bazë të kualifikimeve të tyre profesionale. Puna e KQZ-së është teknike, profesionale.

KQZ-ja merr vendime me koncensus. Nëse nuk mund të arrihet koncensusi, kryesuesi merr vendimin e nevojshëm përfundimtar.

KQZ-në e përkrah sekretariati që është përgjegjës për hartimin e rregullave zgjedhore i cili e këshillon KQZ-në lidhur me standardet dhe përvojat ndërkombëtare zgjedhore si dhe publikimin e vendimeve të KQZ-së. Departamenti i operacioneve të zgjedhjeve (DOS) i OSBE-së është përgjegjës për realizimin e rregullave zgjedhore të miratuara nga KQZ-ja. Në të shumtën e rasteve KQZ-ja ia jep autoritetin DOS-it që të publikojë procedurat administrative për realizimin e rregullave zgjedhore.

Për informata të tjera, kontaktoni me

Zyrën për informim publik të OSBE-së, Prishtinë

Zyra e shtypit: +381 38 500 162 ext. 260

Zyra e informimit publik: +381 38 500 162 ext. 145

Fax: +381 38 500 188 E-mail: press@omik.org

Website: www.osce.org/kosovo

UNMIK



Komisionet Komunale Zgjedhore

Komisionet Komunale Zgjedhore (KKZ) luajnë rol qenësor në përgatitjet për zgjedhje transparente dhe efikase. Këto organe janë krijuar për herë të parë nga KQZ-ja para zgjedhjeve komunale që të japin ndihmesë në administrimin e procesit zgjedhor në nivelin komunal.

Çdo KKZ përbëhet nga tre deri në shtatë komisioner, varësisht nga madhësia e komunës dhe përfaqësuesit e komuniteteve të vogla të komunës. Komisionerët rekrutohen nga komuna dhe emërohen nga KQZ-ja. Çdo KKZ ka një Zyrtar ekzekutiv që siguron se KKZ-ja i kryen obligimet ndaj komunës dhe KQZ-së. Meqë puna e KKZ-ve është teknike dhe profesionale, anëtarët e saj duhet të tregohen administrues profesionistë dhe të kenë përvojë zgjedhore.

Roli i KKZ-ve shtohet gjatë çdo procesi të zgjedhjeve në Kosovë, meqë këto organe gradualisht janë duke marrë në duart e veta administrimin e nivelit lokal në procesin e zgjedhjeve në të ardhmen. Detyra e tyre është që të siguroj informata për votuesit, partitë politike, iniciativat qytetare dhe kandidatët e pavarur lidhur me të drejtat dhe obligimet e tyre si dhe informata për kuvendet komunale lidhur me statusin e aktiviteteve zgjedhore administrative në komunat e tyre, emërimin dhe trajnimin e personelit të shërbimit të votuesve në këshillat e vendvotimeve, përgatitjet teknike në vendvotime dhe sigurimin e një udhëheqje të mirëfilltë të procedurës së votimit dhe numërimit.

Nënkomisioni Zgjedhor i Ankesave dhe Parashtresave

Nënkomisioni Zgjedhor i Ankesave dhe Parashtresave (NKZAP) është organ përgjegjës për shqyrtimin e të gjitha ankesave lidhur me shkeljen e të gjitha rregullave dhe rregulloreve në fuqi gjatë procesit zgjedhor. Është themeluar nga KQZ-ja më 24 maj 2001.

NKZAP-ja përbëhet nga një komisioner ndërkombëtar dhe tre deri në pesë zëvendëskomisionerë nga Kosova. Të gjithë anëtarët e NKZAP-së emërohen nga KQZ-ja bazuar në kompetencat dhe paanshmërinë e tyre. Personeli ndërkombëtar dhe ai vendor i ndihmon NKZAP-së në kryerjen e detyrave të saj.

Secili person i cili ka interes ligjor apo që pohon se të drejtat e tij/ saj lidhur me procesin ligjor janë mohuar me shkelje të cilësdo rregulle zgjedhore, mund të parashtojë ankesë në NKZAP. Kjo përfshin votuesit e regjistruar, partitë politike, koalicionet, iniciativat qytetare dhe kandidatët e regjistruar, vëzhguesit e akredituar zgjedhor si dhe KQZ-ja. Përveç kësaj, NKZAP-ja mund të merr rastet për shqyrtim vetë përbrenda juridiksionit të saj.

NKZAP-ja ndëshkon kur shkelen rregullat zgjedhore, ndëshkimet ndryshojnë duke filluar prej masave korigjuese e deri te ndalimi i pjesëmarrjes së një personi apo subjekti politik në zgjedhje.

KQZ Anëtarësia

Kryesuesi
Ambasadori Paskal Fieschi
*Zëvendës i PSSP-së i ndërtimit të Institucioneve,
Udhëheqësi i Misionit të OSBE-së*

Friedhelm Frischenschlager
Udhëheqëse e Departamentit të OSBE-së së Demokratizimit

Neihart Hoefler - Wissing
Zyra e PSSP-së

Arsim Janova
Prokuror

Esad Hafiz
Përfaqësues i komunitetit turk

Ismet Salihu
Prokuror

Haxhi Rama
Prokuror

Hamide Kunushevcu
Ekonomiste

Halit Ferizi
Përfaqësues i OJQ-ve

Daut Dauti
Prokuror, gazetar

Miodrag Brkljac
Përfaqësues i komunitetit serb

Shefket Ajrudin
Përfaqësues i komunitetit boshnjak

Susan Carnduff
*Ish zyrtar, drejtoresha e
operacioneve të zgjedhjeve*

Andrew Caldwell
*Udhëheqës i Sekretariatit të KQZ-së,
Këshilltari kryesor ligjor*

